

Data: 07/06/2023

PROÇESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROÇEDURËS: "BLERJE RROBA PUNE DHE PAJISJE MBROJTËSE INDIVIDUALE NË VENDIN E PUNËS PËR PUNONJËSIT E HIDROCENTRALEVE TË KESH SH.A".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Veshje profesionale, rroba pune të veçanta dhe aksesori-18100000-0.

VLERA E FONDIT LIMIT: 22,000,000 (Njëzet e dy milion) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Në Nenin 82, të LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të

vetdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke marrë ne konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatën ISO ose ekuivalentin e saj, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatën ISO në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në furnizim/shërbim të përcaktuar në aktmarrëveshje.

Argumentimi:

Kërkesa në lidhje me këtë çertifikatë është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse produktet e marra nga furnitorët janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve. Ky standart na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, pra ky standard mundëson menaxhimin e cilësisë dhe vlerësimin e konformitetit duke rritur performancën dhe besueshmërinë për cilësinë dhe garancinë e mallrave që do të furnizohen nga operatori ekonomik fitues, kështu që mallrat e furnizuara të jenë të sigurta dhe të cilësisë së mirë.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij për periudhën Shkurt 2023 - Prill 2023 jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës, ku prej të cilëve të paktën 2 (dy) punonjës të jenë të çertifikuar nga kompani ose institucione të çertifikuara për stampim dhe 1 (një) punonjës i diplomuar për grafik.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Shkurt 2023 - Prill 2023;

Për 2 (dy) punonjës të jenë të çertifikuar nga kompani ose institucione të çertifikuara për stampim dhe 1 (një) punonjës diplomuar për grafik:

✚ Kontratat e punës;

✚ Çertifikatat përkatëse për (dy) punonjësit (*të çertifikuar nga kompani ose institucione të çertifikuara për stampim*);

✚ Diplomën për 1 (*një*) punonjës (*diplomuar për grafik*).

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Konkretisht:

- Kërkesa se Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij për periudhën Shkurt 2023 - Prill 2023 jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës, është kërkuar pasi Operator ekonomik i cili do të realizojë këtë furnizim duhet të disponojë një minimum kapacitetesh burimesh njerëzore, të cilat do të përbëhen nga punonjës administrative, punonjës shërbimi teknik, punonjës ndihmës, etj..., për të cilët nuk kërkohet asnjë specifikim për cilësi të caktuara, por vetëm që të kenë qenë të punësuar, në mënyrë që të tregohet se OE zotëron mundësinë për realizimin me sukses të kësaj kontrate.

- 2 (dy) punonjës të jenë të çertifikuar nga kompani ose institucione të çertifikuara për stampim dhe 1 (një) punonjës diplomuar për grafik janë kërkuar pasi Autoriteti Kontraktor nëpërmjet kësaj procedure ka kërkuar të blejë mallra rroba pune, të cilat përveçse duhet të disponojnë cilësitë e kërkuara në specifikime teknike, duhet që edhe të individualizohen me Logon e Autoritetit Kontraktor. Autoriteti Kontraktor synon që mallrat që do të blihen duhet të jenë të personalizuar me Logon e Autoritetit Kontraktor. Për këtë është parashikuar stampimi i Logos së Autoritetit Kontraktor dhe për rrjedhojë është kërkuar që të vërtetohet edhe kapaciteti teknik i Operatorëve Ekonomik pjesëmarrëse duke mos kërkuar vetëm ekzistencën e pajisjeve që e mundësojnë këtë proces por edhe ekzistencën e aftësisë teknike, nëpërmjet punonjësve, për realizimin e këtij procesi.

Periudha e kërkuar Shkurt 2023 - Prill 2023 është minimale pasi vërtetohet qëndrueshmërinë e stafit dhe rezultatet pranë Operatorit Ekonomik.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim/et e prodhuesi/ve ose distributor/ve të autorizuar për të gjitha mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

- Në rast se Operatori Ekonomik është vet prodhues duhet të paraqesë një deklaratë për mallrat objekt prokurimi të cilat prodhon.
- Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, çertifikatë, deklaratë etj).
- Operatori Ekonomik do të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë prodhuesit e mallrave objekt prokurimi me të dhënat e kontaktit.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për autorizim/et e prodhuesi/ve ose distributor/ve të autorizuar për të gjitha mallrat objekt prokurimi është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat e konformitetit të produktit final nga prodhuesi *që vërtetojnë se mallrat objekt prokurimi të mëposhtëm janë në përputhje me të gjitha parametrat tekniko - fizike të kërkuara në specifikimet teknike:*

- Kominoshe pambuku, kostum pune, xhupa fosforishent, çizme gome (antivaj), doreza pune, bluza pambuku fosforishente, kaska mbrojtëse, doreza meshini, doreza pune lëkure, doreza një përdorimi, jelek fosforishent, këpucë me qafë dhe syze mbrojtëse.
- Për mallrat e tjerë duhet të paraqitet skeda teknike ose fragmente katalogu të prodhuesit të përkthyer në gjuhën shqipe.

Argumentimi:

- Certifikatat e konformitetit të produktit final për produktet e kërkuara janë të nevojshme pasi dëshmojnë se produktet e kërkuara janë në përputhje me normat europiane pra, e sigurojnë AK se produktet kanë përputhshmëri europiane dhe lejohen për tregëtim në komunitetin European sipas direktivave përkatëse.

Çertifikatat e konformitetit janë kërkuar për të vërtetuar se mallrat e kërkuara sipas kriterit 2.3.5 "Kominoshe pambuku, kostum pune, xhupa fosforishent, çizme gome (antivaj), doreza pune, bluza pambuku fosforishente, kaska mbrojtëse, doreza meshini, doreza pune lëkure, doreza një përdorimi, jelek fosforishent, këpucë me qafë dhe syze mbrojtëse", janë në përputhje me të gjitha parametrat tekniko - fizike të kërkuara në specifikimet teknike.

- Kërkesa për skedën teknike ose fragmente katalogu të prodhuesit është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

Kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe duke qenë se, autoriteti kontraktor është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë së mallrave në përputhje me specifikimet teknike. Certifikatat e konformitetit kërkohet si siguri për produktet e ofertuara, që përmbushin standartet e kërkesat e bashkimit european si për produktet brënda dhe jashtë tij.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira këto pajisje:

- ✚ 1 (një) makineri stampimi;
- ✚ 1 (një) makineri qëndisje;
- ✚ 1 (një) furrë për tharjen e stampimit;
- ✚ 1 (një) prese për ngjitjen e logove;

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramentit dhe më pas, përpara publikimit të

njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre apo marrjen me qira të tyre: (faturë tatimore të shitblerjes/aktet e zhdoganimit, origjinale ose fotokopje të noterizuar, ose kontratë qiraje të noterizuar e cila duhet të jetë me afat zbatimi deri në përfundimin e kontratës.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt e mëposhtëm:

- Kominoshe pambuku, kostum pune, xhupa fosforishent, çizme gome (antivaj), doreza pune, bluza pambuku fosforishente, kaska mbrojtëse, doreza meshini, doreza pune lëkure, doreza një përdorimi, jelek fosforishent, këpucë me qafë, syze mbrojtëse, kapele pune, mushama shiu të gomuar, bluza pune dhe peshqir.

Dorëzimi i mostrave të bëhet ditën e hapjes së kesaj procedure para Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Mostrat duhet të jenë të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur, së bashku me mostrat, Operatori Ekonomik duhet ta bejë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti. Mosparaqitja e të gjitha mostrave është kusht skualifikimi. Operatorët ekonomik mund të dorëzojnë mostrat e tyre të cilat kërkohen me ngjyra të ndryshme edhe vetëm me njërën prej ngjyrave të kërkuara ne specifikimet teknike.

Argumentimi:

Kërkesa për mostrat është kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të kërkuara si mostra duke u nisur nga pesha dhe rëndësia që ato kanë për mbarëvajtjen e proçeseve të punës.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

I. Argumentimi i specifikimeve teknike:

- Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.
- Këto specifikime teknike janë realizuar në bazë të kërkesave specifike të 3 (tre) hidrocentraleve të KESH sha në bazë të RREGULLORES SË PËRGJITHSHME MBI PAJISJEN ME RROBA TË PUNËS, MJETE MBROJTËSE TË PUNONJËSVE NË HIDROCENTRALET E FIERZES, KOMANIT DHE VAU I DEJËS dhe në bazë të natyrës dhe proceseve të punës në objektet përkatëse.

Njësia e Prokurimit